



REPUBLIKA E ALBANIË

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

Nr. 60/1  
Dt. 5.11.2018

VENDIM

Nr. 60/1 datë 29.10.2018

Për

Miratimin e kërkesës për marrje leje "Miratim në parim" subjektit "B & K IMPORT INC" ,për shfrytëzimin e përroit të Zdrajshit dhe të Floqit, degë e lumit Shkumbin, në Bashkinë Librazhd për ndërtimin e HEC ÇERMENIKA, për qëllime hidroenergjie.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d , neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Per miratimin e kushteve të pergjithshme e të posaçme, dokumentave shoqëruse, afatit të vlefshmërise, formularve të aplikimit për autorizime dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016 të Keshillit Kombëtare të Ujit "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor",

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin .

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës për marrje leje "Miratim në parim" subjektit "B & K IMPORT INC" ,për shfrytëzimin e përroit të Zdrajshit dhe të Floqit, degë e lumit Shkumbin, në Bashkinë Librazhd për ndërtimin e HEC ÇERMENIKA, për qëllime hidroenergjie.

*Kordinatat e marrjes së ujit.*

X 44 36 610

Y 45 72 160

Z 830 m m.n.d

*Prurja e llogaritur*

*0.160 m<sup>3</sup>/sek*

*Prurja mesatre*

*0.180 m<sup>3</sup>/sek*

*Prurja ekologjike*

*0.010 m<sup>3</sup>/sek*

Kordinatat e pikës së shkarkimit :

X 44 38 590

Y 45 71 840

Z 660 m m.n.d

Prurja e shkarkimit 0.180 m<sup>3</sup>/sek.

Trupi uhor pritës

Përrua

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do të jetë 190 kw.

Për përdorimin e këtij burimi uhor duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:


- Të mos çënoj furnizimin me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të perspektivës.
- Të zbatoj grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (l/s) për cdo vit të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atij Qendror.
- Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit .
- Të respektojë rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËS ABU**

**SHKUMBIN**

**Dashamir BICAKU**



**KRYETARI I KBU**

**SHKUMBIN**

**Maksim M...**

